

KLSH MBYLL ME SUKSES PJESËMARRJEN NË AUDITIMIN PARALEL TË PERFORMANCES ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

*nga Gjovalin PREÇI- Kryeauditues,
botuar në gazetën "55", më 26 qershor 2015.*

Gjykata Evropiane e Audituesve në Luksemburg, zhvilloi workshop-in përmbyllës të Auditimit Paralel të Performancës mbi Eficiencën e Energjisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, pjesë e të cilit ka qenë dhe KLSH, i fokusuar në përdorimin e burimeve alternative të energjisë.

Ky takim pune u drejtua dhe u menaxhua nga një grup ekspertësh në fushën e metodologjisë dhe auditimeve të performancës të Zyrës së Auditimit të Suedisë (SNAO), Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) dhe Përfaqësuesit të Grupit të Përbashkët të Punës për Aktivitetet e Auditimit (JWGAA) të Institucioneve Supreme të Auditimit të BE-së. Krahas KLSH, morën pjesë përfaqësues nga SAI-t e Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë, Bosnje-Hercegovinës, auditues nga ECA, etj.

Me interes të veçantë u ndoqën prezantimet *"Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet - parimet dhe praktikat më të mira"* nga ekspertët e SNAO-s, duke evidentuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 300) mbi vlerësimin e evidencës dhe krijimin e vlerës së shtuar, kërkesat që duhet të plotësojnë raportet e auditimit në lidhje me besueshmërinë, objektivitetin,

qartësinë në shkrim, etj. Në vijim të kësaj teme u trajtuan sfidat e procesit auditues, marrja e evidencës, organizimi dhe sistemimi i gjetjeve, udhëheqja e auditimit, etj., të shoqëruara me shembuj nga praktika e të gjitha vendeve pjesëmarrëse.

Tema *“Leximi miqësor i raportit - workshop mbi komunikimin e mesazheve të qarta”* transmetoi tek pjesëmarrësit parimet kryesore, strukturën e raportit, rëndësinë e mesazhit të auditimit, ndërtimi dhe formulimi i paragrafëve dhe vendosja e tekstit, figurave dhe tabelave, menaxhimi i evidencës dhe observacioneve, etj.

Elementë mjaftë i rëndësishëm i raportit të auditimit është *“Paraqitja e të dhënave”*, e cila u demonstrua me mjaft profesionalizëm nga ekspertë të ECA-s.

Nga një pjesëtar i grupit të auditimit të performancës *“Mbi përhapjen e karbonit në hapësirë”* të ECA-s, shpjegoj gjithë procedurën e ndjekur që nga nisja e këtij auditimi, fazën studimore, përgatitjen e projekt raportit, komunikimin me palët e interesuara (kryesisht Komisionin Evropian), paraqitjen e observacioneve, hartimin e raportit final, etj.

“Zhvillimi institucional i ECA” ishte një prezantim i veçantë mbi numrin dhe rritjen e rëndësisë së auditimeve të performancës, marrjes të sa më shumë mesazheve nga palët e interesuara deri në publikimin e raporteve etj. Gjithashtu u evidentua dhe perspektiva e zhvillimit të ECA, duke filluar nga fillim viti 2016, që do të bëhet më fleksibël, duke u organizuar mbi bazën e detyrave etj. Cilësia e kontrollit merre një kohë të konsiderueshme për

çështje të analizës, adresimit të kërkesave të palëve të interesit etj., në zbatim të ISSAI 40.

Temat e paraqitura janë gërshetuar vazhdimisht me praktika ushtrimore që t'i shërbejnë sa më shumë pjesëmarrësve për zbatimin e mësimëve të dalta gjatë këtij projekti, në të ardhmen gjatë auditimeve të performancës.

Gjatë tre ditëve të punës, grupi i auditimit të KLSH paraqiti për diskutim një përmbledhje të draft Projekt raportit të këtij auditimi, i fokusuar në *“Përdorimin e burimeve alternative të energjisë elektrike”*, duke u përqendruar në gjetjet, konkluzionet dhe mesazhin kryesor të këtij auditimi. Ekspertët e SNAO-s dhe kolegët e vendeve tjera dhanë vlerësimet e tyre për punën e arrirë në një kohë relativisht të shkurtër, duke sugjeruar disa përmirësime që do t'i shërbejnë veprimtarisë audituese të performancës në të ardhmen. Nga pjesëmarrësit dhe ekspertët auditues në nivel ndërkombëtar të këtij workshop-i u vlerësua konkluzioni paraprak i këtij auditimi. Megjithëse Shqipëria ka kryer përafrimin e legjislacionit sipas kërkesave të BE-së dhe ka hartuar Planin Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Eficiencës së Energjisë, nuk ka arritur të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike, pasi: Strategjia Kombëtare e Energjisë nuk është monitoruar dhe zbatuar sipas skenarëve përkatës; Plani Kombëtar i veprimit prej më se 3 vitesh nuk është miratuar akoma; ligji për burimet e rinovueshme vazhdon të mos prodhojë efektet ekonomike dhe juridike për shkak se është shtyrë zbatimi i tij; kanë munguar iniciativat publike në këtë fushë për shkak të performancës së dobët të MEI-t dhe AKBN-së nga mungesa e financimeve buxhetore dhe ndarjes e dublikimit

të kompetencave organizative dhe administrative brenda e midis tyre. Në këtë mënyrë workshop-i konstatoi se është plotësuar objektivi specifik këtij auditimi, që duke analizuar kuadrin ekzistues rregullator, performancën e zbatimit të politikave institucionale publike dhe efektivitetin e stimujve të ofruar nga Qeveria për rritjen e përdorimit të burimeve alternative të energjisë, të arrihet në përfundime mbi përmirësimin e qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet prodhimit dhe përdorimit me efektivitet të potencialit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike në mënyrë miqësore me mjedisin.

Ky workshop ja arriti synimeve të tij për diskutimin e konkluzioneve e rekomandimeve, si dhe raporteve të auditimeve të përgatitura nga vendet e pjesëmarrëse, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së auditimeve të performancës.

Në fund të workshop-it u diskutua dhe u vlerësua mbi projektin tjetër të bashkëpunimit midis vendeve pjesëmarrëse në forcim të rolit dhe rëndësisë së auditimeve të performancës dhe cilësisë së tyre.